7662

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT - TIRANË
Nr. 7662 Akti

VENDIM

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Unë, gjyqtare _____, mbasi u njoha me materialet e paraqitura nga kërkuesit z.Gianfranco LIUZZI dhe z.Angela CAMPANELLA për riregjistrimin e firmës "TEKNOTRADE LTD." e cila ka qenë e regjistruar si person juridik, në bazë të vendimit 2018 datë 17.2.1993 të Gjykatës së Tiranës,

KONSTATOVA

Kërkesa e paraqitur nga kërkuesit për riregjistrimin e firmës "TEKNOTRADE LTD." duke marrë formën e një shoqërie tregtare private (sh.p.k) me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr. 7638 datë 19.11.1992 për shoqëritë tregtare, duhet pranuar sepse formalitetet e regjistrimit dhe kushtet materiale i ka në përputhje me ligjin dhe në bazë të ligjit duhet të pranohet.

PËR KËTË ARSYE

Në bazë të nenit 5 të ligjit Nr.7512 datë 10.8.1991, të ligjit 7638 datë 19.11.1992, dhe të ligjit 7667 datë 28.1.1993

VENDOSA

Riregjistrimin si person juridik të firmës "TEKNOTRADE LTD " duke marrë formën e një shoqërie tregtare private me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "TEKNOTRADE LTD.", për të ushtruar aktivitetin tregtar në fushën :

1. Në fushën e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të import eksportit si ushqimore, artikuj industrialë, konfeksione kinkalerira, pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike, materiale mjeksore, dentare, filma, kaseta audio, video, materiale ndërtimi, makineri e pajisje të ndryshme të import - eksportit.
2. Në fushën e shtypit dhe të botimeve të ndryshme si dhe të tregtimit të tyre.
3. Në fushën e hotelerisë, agjenci turizmi, spedicion, ndërmjetësi, agjenci doganore etj.
4. Në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit.
5. Në fushën e projektimit, realizimit dhe drejtimit të impianteve radiofonikë e televizivë.
6. Në fushën e ndërtimeve qytetare dhe industriale.
7. Në fushën e operacioneve financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, Tiranë.

TIRANË, me 19.10.1993

GJYQTARJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT - TIRANË
Nr. 67 Vendimi

VENDIM

Në Tiranë, sot me datë 21.10.1993, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Donika DETI, morra në shqyrtim kërkesën e :

1. Gianfranco LIUZZI, i biri i Oronzos dhe i Giuseppinës, lindur më 6.4.1947 në Locorotondo (BARI), banues në Bari, në Viale della Repubblica, 71/G, me pasaportë nr. 804081, dhe

2. Angela CAMPANELLA, e bija e Cataldos dhe Giuseppinës, lindur më 21.5.1948 në Locorotondo (BARI) dhe banuese në Bari, në Viale della Repubblica, 71/G, me pasaportë nr. 804082,

për shtyrje afati për plotësimin e dokumentacionit për riregjistrim si person juridik dhe

KONSTATOVA

Kërkuesit Gianfranco LIUZZI dhe Angela CAMPANELLA kanë regjistruar në këtë Gjykatë firmën "TEKNOTRADE LTD.", e cila është njohur si person juridik me vendimin nr.2018 dt. 17.2.1993.

Në bazë të Ligjit Nr.7667 dt. 28.1.1993 kërkuesit do të bëjnë riregjistrimin e firmës sa më sipër. Për kryerjen e këtij veprimi ata kanë humbur afatin ligjor.

Asnjë nga palët e parashtruara në kërkesën për rivendosje në afatin e humbur çmohen se janë të përligjura, sepse duke qenë shtetas të huaj dhe duke u marrë me aktivitetet e firmës brenda dhe jashtë vendit, nuk kanë mundur që të marrin dijeni në kohë për dokumentacionin e kërkuar dhe për ta depozituar atë brenda afatit të caktuar nga ligji në Gjykatë, për t'u riregjistruar në regjistrin tregtar. Për rrjedhojë çmoj se kërkesa e tyre për shtyrje afati për riregjistrim duhet pranuar.

Për këto arsye, në bazë të Ligjit Nr.7667 dt.28.1.1993

VENDOSA

Miratimin e kërkesës së Gianfranco LIUZZI dhe Angela CAMPANELLA dhe rivendosjen e tyre në afat për plotësimin e dokumentave përkatëse, për t'u riregjistruar edhe për 3 (tre) muaj kohë, duke filluar ky afat nga data e paraqitjes së kërkesës dt. 21.10.1993.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim.

Tiranë, më 21.10.1993

GJYQTARJA

Donika DETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 4662/1

V E N D I M

" I GJYQTARIT TE VETEM "

Une gjyqtarja e vetme, [illegible] , ne gjykaten e Rrethit Tirane, sot ne daten 28 . 04. 2000 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga **z. Gianfranco LIUZZI** per depozitimin e **Vendimit Nr. 1 date 13.03.2000** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " **TEKNOTRADE** " **Sh.p.k.** dhe

K O N S T A T O V A :

Se me Vendimin **Nr. 2018 date 17.02.1993** eshte rregjistruar si person juridik shoqeria " **TEKNOTRADE** " **Sh.p.k**. me Ortake **z. Gianfranco LIUZZI dhe Angela CAMPANELLA** , me kapital themeltar te Shoqerise **50.000.000** lireta dhe Seli ne Tirane . Me Vendimin **Nr. 1** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise **date 13.03.2000** eshte vendosur te behen keto ndryshime :

- Shitjen e 60 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise me vlere nominale prej 30.000.000 lireta .
- Blerjen e kuotave perkatese te **z. Gianfranco LIUZZI nga zj. Mirela TOPULLI** , te cilat perbejne 60 % te kapitalit fillestar me nje vlere nominale prej 30.000.000 (tridhjete milion) lireta .
- **Zj. Mirela TOPULLI** pranohet si Ortake e Re ne Shoqerine **TEKNOTRADE Sh.p.k.**
- **Z. Gianfranco LIUZZI** largohet nga Shoqeria si Ortak , por do te vazhdoje te mbetet nen cilesine e Administratorit te Shoqerise
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.
- Te njoftohet Gjykata e Rrethit Tirane , per te bere ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregetar te Shoqerise .

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligje dhe si e tille duhet pranuar .

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr. 7512 date 10.08.1991 ,Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 , Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin tregetar ".

V E N D O S A :

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin prane rregjistrit tregetar te **Vendimit Nr. 1 date 13.03.2000** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " **TEKNOTRADE " Sh.p.k.**
- Depozitimin e Kontrates se Shitjes se Kuotave me **Nr. 797 Rep. Nr. 84Kol.** tek notere **Aferdita HAXHIA** .
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.
- Te ndahen regjistrimet nga njeri - tjetri me vije te kuqe , dhe te behen ndryshimet perkatese ne kollonat 4 dhe 5 .

G J Y Q T A R E

Republika e Shqipërisë
Gjykata e Rrethit Tiranë
Nr. 7662/2 Regj

VENDIM
i Gjyqtarit të vetëm

Sot më datë 25/6/2002, unë M. Dogo gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Z.Gianfranco Liuzzi, administrator i shoqërisë tregtare "TEKNOTRADE " sh.p.k. për pasqyrimin në regjistrin tregtar të ndryshimeve në dokumentacionin e shoqërisë.

KONSTATOVA

Shoqëria tregtare " TEKNOTRADE" sh.p.k. është person juridik regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së rrethit Tiranë, me vendimin nr. 2018, datë 17.03.1993 Ortak te shoqërise jane Anxhela Kampanella dhe Mirela Topulli.Administrator I shoqërisë është z. Z.Gianfranco Liuzzi. Selia e shoqërisë eshte ne Rr "Tefta Tashko" nr.7. Me vendimin nr 7662/1, datë 28.04.2000, janë bërë ndryshime ne statutin e kesaj shoqërie të cilat janë pasqyruar në Regjistrin Tregtar.

Me date 10.01.2001, është mbledhur Asambleja e Ortakeve te shoqërisë, me pjesmarrjen e plote te tyre dhe me rend dite: dikutimin e miratimit te transferimit te kuotave te kapitalit themeltar ne zoterim te zj Mirela Topulli, tek Z.Gianfranco Liuzzi dhe reflektimine ketyre ndryshimeve ne dokumentacionin e shoqërise. Sipas procesverbalit te mbledhjes me vendimin nr.2 është vendosur:

1. Shitja e 60% te kuotave te kapitalit fillestar te shoqërise me vlere nominale prej 30 000 000.
2. Blerja e kuotave perkatese te zj Mirela Topulli nga z. Gianfranco Liuzzi.
3. Z.Gianfranco Liuzzi pranohet si ortak I ri I shoqërisë TEKNOTRADE" sh.p.k
4. zj Mirela Topulli largohet nga shoqëria si ortake.

Për arsyet e mësipërme kërkohet nga Gjykata që të pasqyrohen këto ndryshime në dokumentacionin e shoqërisë.
Gjykata pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe e konsideroi në përputhje me ligjin është e mendimit të pranojë kërkesën e paraqitur nga administratori i shoqërisë TEKNOTRADE" sh.p.k.

PER KETO ARSYE:

Në bazë të ligjit nr. 7638 dt. 19. 11.1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit nr 7667 dt. 28.01.1993 " Për regjistrin tregtar".

V E N D O S A:

1. Pranimin e kërkesës së bërë nga "TEKNOTRADE" sh.p.k.
2. Urdhërimin e depozitimit në Regjistrin Tregtar të vendimit nr.2, datë 1 0.01.2001 të Asamblese se Ortakeve dhe te kontrates se shijes se kuotave te kapitalit Nr.175 Rep. Nr. 28 kol. datë 10.01.2001
3. Të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin tregtar.

GJYQTARJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË
Nr. i Vendimit 7662/3

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 04.03.2003, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë, Marjana Dedi, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Administratorët e Shoqërisë së të drejtës shqiptare TEKNOTRADE SHPK, Z. Geront Selenica dhe Z. Gianfranco Liuzzi, si edhe dokumentet e tjera bashkëngjitur kësaj kërkese,

KONSTATOVA:

Shoqëria TEKNOTRADE SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare është riregjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin gjyqësor nr. 7662, datë 19.10.1993.

Më datën 14.02.2003, u mblodh Asambleja e Ortakëve të kësaj Shoqërie, e cila mori vendimet e mëposhtme:

1. të miratojë transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë TEKNOTRADE SHPK që zotërohen nga Znj. Angela Campanella në favor të Z. Geront Selenica si edhe lidhjen e kontratës së transferimit të pjesëve të kapitalit midis Znj. Angela Campanella, në cilësinë e Shitëses dhe Z. Geront Selenica, sipas së cilës Z. Geront Selenica do të blejë të gjithë kuotën e pjesëmarrjes të Znj. Angela Campanella, të barabartë me 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë TEKNOTRADE SHPK;

2. të miratojë transferimin e 11% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë që zotërohen nga Z. Gianfranco Liuzzi në favor të shoqërisë The Point sh.p.k. si dhe lidhjen e kontratës së shitjes të pjesëve të kapitalit midis Z. Gianfranco Liuzzi, në cilësinë e Shitësit dhe shoqërisë The Point sh.p.k. të përfaqësuar nga Znj. Evis Frashëri, sipas së cilës shoqëria The Point sh.p.k. do të blejë 11% (njëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë TEKNOTRADE SHPK;

3. të emërojë Z. Geront Selenica si administrator të Shoqërisë. Si rrjedhojë, Shoqëria TEKNOTRADE SHPK do të ketë dy administratorë, të cilët mund t'a përfaqësojnë shoqërinë vecas.

Në të njëjtën datë, pra më 14.02.2003, në përputhje me vendimet e mësipërme të marra nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, janë lidhur edhe kontratat përkatëse të shitblerjes së

pjesëve të kapitalit, si pasojë e të cilave përbërja e kapitalit themeltar të Shoqërisë TEKNOTRADE SHPK rezulton si më poshtë vijon:

ORTAKË	PJESËMARRJA
Gianfranco Liuzzi	49%
Geront Selenica	40%
The Point Sh.p.k	11%
TOTALI	**100%**

Administratorët e Shoqërisë TEKNOTRADE SHPK i kanë kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë-Tiranë depozitimin e Procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë të datës 14.02.2003, të kontratave të transferimit të shitjes së pjesëve të kapitalit si edhe dokumenteve të tjera bashkëngjitur.

PËR KËTO ARSYE

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës;

- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë TEKNOTRADE SHPK, të datës 14.02.2003, të kontratave të transferimit të pjesëve të kapitalit të datës 14.02.2003 si edhe të dokumenteve bashkëngjitur.

- Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _____, në kolonën __4__ duke ndarë regjistrimet me të kuqe.

Tiranë, 04/02/2003

GJYQTARE

Marjana Dedi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 7662/ 4 **VENDIMIT**

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 30/09/2003 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k, z. Geront Selenica per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar „ Teknotrade" Sh.p.k

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "TEKNOTRADE"sh,p.k eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr, date 19.10.1993, ortake Z.Gianfranco Liuzzi, Geront Selenica dhe shoqeria "The Point" sh.p.k. zoterues perkatesisht te 49%, 40% dhe 11% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie dhe objekt te percaktuar sipas nenit 5 te statutit te kesaj shoqerie. Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise me vendimin nr. 4, date 24.09.2003, ka vendosur:

1. Neni 4 i Aktit te Themelimit te shoqerise si dhe neni 5 i Statutit te shoqerise ndryshohen si vijon:

OBJEKTI

Objekti do te jete ekskluziv per veprimtari televizive qe perfshin :

-Pprodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesave, sateliteve apo me cdo mjeti tjeter.

- Aktiviteti i shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jeten private te njeriut, si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.

Shoqeria mund te financohet nepermjet reklamesdhe sponsorizimeve ne perputhje me sa parashikon legjislacioni ne fuqi.

- Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te Shoqerise dhe qellimeve te saj shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen me qellimin e mesiperm, te marre interesa jo aksionere ne Shoqeri apo persona te tjere juridik te cilet mund te kene qellime te tjera por qe lidhen me aktivitetin televiziv.

Ndryshimi i objektit te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k eshte miratuar edhe nga asambleja e ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ortake ne shoqerine "TEKNOTRADE" sh.p.k, me vendimin nr 2 date 25.03.2003

Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesi ka kerkuar :

– Depozitimin e vendimit nr 4 date 24.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

- Depozitimin e vendimit nr 2 date 25.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise "TEKONTRADE" sh.p.k.

Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe 7638 date 1911.1992 „per Shoqerite tregetare „

V E N D O S A.:

Pranimin e kerkeses,

- Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr 4, date 24.09.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise „ TEKNOTRADE "sh.p.k
- Depozitimin e vendimit nr 2 date 25.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
- Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne Regjistrin Tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Gjyqtare
Enkela BAJO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 7662/5 VENDIMIT

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 1/10/2003 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k, z. Geront Selenica per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar „ Teknotrade" Sh.p.k

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "TEKNOTRADE"sh,p.k eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr, date 19.10.1993, ortake Z.Gianfranco Liuzzi, Geront Selenica dhe shoqeria "The Point" sh.p.k. zoterues perkatesisht te 49%, 40% dhe 11% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie dhe objekt te percaktuar sipas nenit 5 te statutit te kesaj shoqerie e kapital themeltar 100 000. Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise me vendimin nr. 5, date 29.09.2003, ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise ne kontribute ne natyre ne perputhje me kontributet e ortakeve ne shoqeri.
2. Caktimin e Ekspertes kontabel te autorizuar Migela Xhani per kryerjen e aktit te ekspertimit .
3. Depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
4. Ngarkimin e administratorit te shoqerise Geront Selenica te ndjeke procdeurat e pasqyrimit te ndryshimeve te mesiperme ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane .
5. Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

Me vendimin nr 3 date 29.09.2003 asambleja e ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ,ortake ne shoqerine "TEKNOTRADE" sh.p.k ka vendosur

1. Te miratoje Zmadhimin e kapitalit te shoqerise "TEKNOTRADE" Sh.p,k ne kontribut ne natyre ne perputhje me kontributet e ortakeve ne shoqeri.
2. Te miratoje Caktimin e Ekspertes kontabel te autorizuar Migela Xhani per kryerjen e aktit te ekspertimit .
3. Ngarkimin e administratorit te shoqerise Evis Frasheri te nenshkruaje per shoqerine "THE POINT" ne vendimin e asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise .
4. Me kerkesen drejtuar Gjykates administratori i shoqerise ka kerkuar :

– Depozitimin e vendimit nr 5 date 29.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

– Depozitimin e vendimit nr 3 date 29.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

– Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise "TEKONTRADE" sh.p.k.

Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe 7638 date 1911.1992 „per Shoqerite tregetare „

V E N D O S A.:

Pranimin e kerkeses,

– Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr 5, date 29.09.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise „ TEKNOTRADE "sh.p.k

– Depozitimin e vendimit nr 3 date 29.09.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

– Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne Regjistrin Tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Gjyqtare
Enkela BAJO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 7662/6 VENDIMIT

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 03.10.2003 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k, z. Geront Selenica per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar „ Teknotrade" Sh.p.k

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "TEKNOTRADE"sh,p.k eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr, date 19.10.1993, ortake Z.Gianfranco Liuzzi, Geront Selenica dhe shoqeria "The Point" sh.p.k. zoterues perkatesisht te 49%, 40% dhe 11% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie dhe objekt te percaktuar sipas nenit 5 te statutit te kesaj shoqerie e kapital themeltar 50 000 000 lireta. Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise me vendimin nr. 5, date 29.09.2003, ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise ne kontribute ne natyre ne perputhje me kontributet e ortakeve ne shoqeri.
2. Caktimin e Ekspertes kontabel te autorizuar Migela Xhani per kryerjen e aktit te ekspertimit .

   Me vendimin nr 3 date 29.09.2003 asambleja e ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ,ortake ne shoqerine "TEKNOTRADE" sh.p.k ka vendosur

1. Te miratoje Zmadhimin e kapitalit te shoqerise "TEKNOTRADE" Sh.p,k ne kontribut ne natyre ne perputhje me kontributet e ortakeve ne shoqeri.
2. Te miratoje Caktimin e Ekspertes kontabel te autorizuar Migela Xhani per kryerjen e aktit te ekspertimit .

Pas kryerjes se aktit te ekspertimit nga Ekspertja Migela Xhani asambleja e ortakeve te shoqerise me vendimin nr 6 date 03.10.2003 ka vendosur:

1. Miratimin e raportit te ekspertimit te kryer nga ekspertja Migela Xhani.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k me kontribute ne natyre me vleren 23 000 000 leke.
3. Perfundimisht kapitali themeltar i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k pas zmadhimit me kontribute ne natyre ne vleren 23 000 000 leke do te jete:
   - Kapital ekzistues ne vleren 50 000 000 lireta =3.500 000 leke me kursin e dates 19.10.1993
   - Kontribute ne natyre ne vleren 23 000 000 leke .

gjithesej 26 500 000 leke

4. Ruhen te pandryshuara raporti ne % per sejcilin ortak dhe vlera nominale e nje kuote.
5. Depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
6. Ngarkimin e administratorit te shoqerise Geront Selenica te ndjeke procdeurat e pasqyrimit te ndryshimeve te mesiperme ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane .
7. Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

Me vendimin nr 4 date 03.10.2003 asambleja e ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ka vendosur :

1. Miratimin e raportit te ekspertimit te kryer nga ekspertja Migela Xhani.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k me kontribute ne natyre me vleren 23 000 000 leke.
3. Perfundimisht kapitali themeltar i shoqerise "TEKONTRADE" sh.p.k pas zmadhimit me kontribute ne natyre ne vleren 23 000 000 leke do te jete:
   - Kapital ekzistues ne vleren 50 000 000 lireta =3.500 000 leke me kursin e dates 19.10.1993
   - Kontribute ne natyre ne vleren 23 000 000 leke .

---

gjithesej 26 500 000 leke.

4. Ruhen te pandryshuara raporti ne % per sejcilin ortak dhe vlera nominale e nje kuote.
5. Ngarkimin e administratorit te shoqerise Evis Frasheri te nenshkruaje per shoqerine "THE POINT" ne vendimin e asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k per miratimin e aktit te ekspertimit te ekspertes Migela Xhani .

Me kerkesen drejtuar Gjykates administratori i shoqerise ka kerkuar :

– Depozitimin e vendimit nr 6 date 03.10.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

– Depozitimin e vendimit nr 4 date 03.10.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

– Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k.

Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe 7638 date 1911.1992 „per Shoqerite tregetare „

V E N D O S A.:

Pranimin e kerkeses,

– Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr 6, date 03.10.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise „ TEKNOTRADE "sh.p.k

– Depozitimin e vendimit nr 4 date 03.10.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

– Depozitimin e raportit te ekspertimit te ekspertes Migela Xhani date 03.10.2003 dhe bilancit te shoqerise

– Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne Regjistrin Tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Gjyqtare
Enkela BAJO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 7662/7 **VENDIMIT**

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 15.10.2003 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k, z. **Geront Selenica** per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar „ TEKNOTRADE" Sh.p.k

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "TEKNOTRADE"sh,p.k eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr, date 19.10.1993,aktualisht me ortake Z.Gianfranco Liuzzi, Geront Selenica dhe shoqeria "THE POINT" sh.p.k. zoterues perkatesisht te 49%, 40% dhe 11% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie me seli ne Tirane Rr "Muhamet Gjollesha". Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise me vendimin date 10.08.2003, ka vendosur:

1. Ndryshimin e selise se shoqerise nga adresa Rr "Muhamet Gjollesha" Tirane , ne adresen Rr "Tefta Tashko" nr 104/6 Tirane .
2. Ngarkimin e administratorit te shoqerise Geront Selenica te ndjeke procedeurat e pasqyrimit te ndryshimeve te mesiperme ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ndryshimi i selise se shoqerise"TEKNOTRADE" sh.p.k eshte miratuar edhe nga asambleja e ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ortake ne shoqerine "TEKNOTRADE" sh.p.k e cila me vendimin date 10.08.2003 ka vendosur

1. Miratimin e ndryshimit e selise se shoqerise "TEKNOTRADE" nga adresa Rr "Muhamet Gjollesha" Tirane, ne adresen Rr "Tefta Tashko" nr.104/6, Tirane.
2. Ngarkimin e administratorit te shoqerise "THE POINT" Evis Frasheri te nenshkruaje per shoqerine "THE POINT" ne vendimin e asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k per ndryshimin e selise se shoqerise.

Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesi ka kerkuar:

– Depozitimin e vendimit 10.08.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

– Depozitimin e vendimit date 10.08.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

– Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise "TEKONTRADE" sh.p.k.

Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe ligjit nr.7638 date 1911.1992 „Per Shoqerite Tregetare „

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses,

– Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit 10.08.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise „ TEKNOTRADE "sh.p.k

– Depozitimin e vendimit date 10.08.2003 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE POINT" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

– Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne Regjistrin Tregtar.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Gjyqtare
Enkela BAJO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 7662/8 VENDIMIT

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 23/10/2003 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Blerina Muçi pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "TEKNOTRADE" sh.p.k, z. Geront Selenica per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar „ TEKNOTRADE" Sh.p.k

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "TEKNOTRADE" sh.p.k eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr 7662, date 19.10.1993, aktualisht me ortake Z.Gianfranco Liuzzi, Geront Selenica dhe shoqeria "The Point" sh.p.k. zoterues perkatesisht te 49%, 40% dhe 11% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie dhe objekt te percaktuar sipas nenit 5 te statutit te kesaj shoqerie. Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise me vendimin nr. 7, date 21/10/2003, ka vendosur:

- Te miratoje dhurimin e kuotave nga ortaku Gianfranco Liuzzi i cili i dhuron te gjitha kuotat e kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine "Teknotrade" sh.p.k Ortakut tjeter Geront Selenica .
- Pas miratimit te ketij dhurimi nga ana e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te Shoqerise Z. Gianfranco Liuzzi largohet nga shoqeria " Teknotrade" sh.p.k si ortak dhe ne te njejten kohe edhe nga funksioni I Administratorit te shoqerise .
- Pas miratimit te dhurimit te kuotave si me siper, nga ana e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te Shoqerise "Teknotrade" sh.p.k kapitali themeltar ne kete shoqeri zoterohet si me poshte:
- 1. Z. Geront Selenica zoteron 89 % te kuotave te kapitalit te shoqerise dhe
  2. Shoqeria " The Point " sh.p.k zoteron 11 % te kuotave te kapitalit te shoqerise
- Z. Geront Selenica mbetet Administrator I vetem I shoqerise " Teknotrade" sh.p.k.
- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.
- Ngarkimin e administratorit te shoqerise Geront Selenica te ndjeke procdeurat e pasqyrimit te ndryshimeve te mesiperme ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane .
- Depozitimin e ketij vendimi ne Zyren e Rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Sa me siper eshte miratuar edhe nga Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve te shoqerise "THE POINT" me vendimin nr. 5, date 21.10.2003.

Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesi ka kerkuar :
Depozitimin e vendimit nr. 7, date 21/10/2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te Shoqerise " Teknotrade" sh.pk, kontrates se dhurimit nr. 2548 Rep, nr.535 Kol, date 21/10/2003 si dhe Vendimit nr. 5, date 21/10/2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise " The Point" sh.p.k ne Zyren e Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutit te shoqerise.
Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe 7638 date 1911.1992 „Per Shoqerite Tregetare „

V E N D O S A.:

Pranimin e kerkeses,

- Depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr. 7, date 21/10/2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise „ TEKNOTRADE "sh.p.k , kontrates se dhurimit nr. 2548 Rep, nr.535 Kol, date 21/10/2003 si dhe Vendimit nr. 5, date 21/10/2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise " The Point" sh.p.k

- Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne regjistrin tregtar.

- Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

GJYQTARE

AKTI THEMELUES

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE " *TEKNOTRADE LTD.*"

Ne mbështetje te Ligjit 7638 dt.19.11.1992, sot në Tiranë, me dt.19.10.1993, ortakët :
1. Gianfranco LIUZZI - biri i Oronzos, lindur në Locorotondo (BARI) me 6.4.1947 me banim në Bari në Viale della Repubblica, 71/G me passaport n. 804081,dhe
2. Angela CAMPANELLA - e bija e Cataldos, lindur në Locorotondo (BARI) me 21.5.1948, banuese në Bari në Viale della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804082
me deshirë dhe vullnet të përbashkët, duke vepruar si themelues të shoqërisë së përbashkët "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.), me seli në Rrugën Muhamet Gjollesha - Tiranë, lidhëm këtë akt themelimi.

FORMIMI

Neni 1

Të formojmë shoqërinë private me përgjegjësi të kufizuar me emrin e plotë : Shoqëria Private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.) .

SELIA

Neni 2

Selia e shoqërisë do të ketë vendqendrimin në Tiranë, fillimisht në lokalin e ndodhur në Rrugën Muhamet Gjollesha, që ndodhet në katin e tretë të Shtëpisë Botuese Enciklopedike.

Shoqëria mund të hapë vendqendrime të tjera të dyta, operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente dhe jashtë saj.

KOHËZGJATJA

Neni 3

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti themelor i veprimtarisë ekonomike do të jetë :

1. Në fushën e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të import eksportit si ushqimore, artikuj industrialë, konfeksione kinkalerira, pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike, materiale mjeksore, dentare, filma, kaseta audio, video, materiale ndërtimi, makineri e pajisje të ndryshme të import - eksportit.
2. Në fushën e shtypit dhe të botimeve të ndryshme si dhe të tregtimit të tyre.
3. Në fushën e hotelerisë, agjenci turizmi, spedicion, ndërmjetësi, agjenci doganore etj.
4. Në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit.
5. Në fushën e projektimit, realizimit dhe drejtimit të impianteve radiofonikë e televizivë.
6. Në fushën e ndërtimeve qytetare dhe industriale.
7. Në fushën e operacioneve financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Që të gjitha këto aktivitete në mënyrë të detajuar do të saktësohen në Aktin e Regjistrimit te Shoqerisë dhe në Statutin e saj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali themelor i shoqerisë është 50.000.000 Lireta që përbëhet 60 % nga Gianfranco LIUZZI dhe 40 % nga Angela CAMPANELLA.

ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :
1 - Asambleja e ortakëve,
2 - Presidenti administrator i shoqërisë.
Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës së organeve drejtuese do të rregullohet me statut.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 7

Shoqëria do të ketë të drejtë të punësojë edhe persona të tretë në të.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 8

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllen me 31 dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçanta të Asamblesë.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 9

Shpërbërja e shoqërisë do të bëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në Statutin e saj.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 10

'President i shoqërisë caktohet Gianfranco LIUZZI. Të drejtën e nënshkrimit në emër të shoqërisë "TEKNOTRADE LTD" (Sh.p.k.) e ka vetëm Presidenti i saj dhe të gjithë personat e autorizuar prej tij me autorizim të posaçëm.

Neni 11

Ky akt themelues u përpilua në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.).

Ortakët :

1. Gianfranco LIUZZI

2. Angela CAMPANELLA

Tiranë, më 19.10.1993

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TEKNOTRADE LTD.

Në mbështetje të Ligjit 7638 dt.19.11.1992, sot në Tiranë, me dt.19.10.1993, ortakët :
1. Gianfranco LIUZZI - i biri i Oronzos, lindur në Locorotondo (BARI) me 6.4.1947 me banim në Bari në Viale della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804081,dhe
2. Angela CAMPANELLA - e bija e Cataldos, lindur në Locorotondo (BARI) me 21.5.1948 banuese në Bari në Viale della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804082
me dëshirë dhe vullnet të përbashkët, duke vepruar si themelues të shoqërisë së përbashkët "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.), me seli në Rrugën Muhamet Gjollesha - Tiranë, formulojmë këtë statut :

Neni 1

Shoqëria që krijohet është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që emërtohet shoqëri tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k).

KOHËZGJATJA

Neni 2

Shoqëria do të kete një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike mbi 10 vjet.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 3

Shoqëria në krijimin e saj ka një kapital themeltar në shumën 50.000.000 Lireta që përbëhet nga derdhjet në masën 60 % nga ortaku Gianfranco LIUZZI dhe në masën 40 % nga ortaku Angela CAMPANELLA.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, fillimisht në adresën Rruga Muhamet Gjollesha, Shtëpia Botuese Enciklopedike, kati II - të.

Shoqëria mund të hapë degë të saj me vendqendrime të dyta , operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente dhe jashtë saj.

Selitë që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen Legjislacionit Shqiptar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

1. Në fushën e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të import eksportit si ushqimore, artikuj industrialë, konfeksione kinkalerira, pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike, materiale mjeksore, dentare, filma, kaseta audio, video, materiale ndërtimi, makineri e pajisje të ndryshme të import - eksportit.
2. Në fushën e shtypit dhe të botimeve të ndryshme si dhe të tregtimit të tyre.
3. Në fushën e hotelerisë, agjenci turizmi, spedicion, ndërmjetësi, dhe agjenci doganore etj.
4. Në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit.
5. Në fushën e projektimit, realizimit dhe drejtimit të impianteve radiofonikë e televizivë.
6. Në fushën e ndërtimeve qytetare e industriale.
7. Në fushën e operacioneve financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Gianfranco Liuzzi

Angela Campanella

ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Organet drejtuese të shoqërisë tregtare do të jenë:
1. Asambleja e ortakëve,
2. Presidenti administrator i shoqërisë.
Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës të organeve drejtuese do të rregullohen me statut.

ASAMBLEJA

Neni 7

Asambleja e shoqërisë tregtare "TEKNOTRADE LTD." do të përbëhet nga dy ortakë themelues. President i saj do të jetë Gianfranco LIUZZI.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria tregtare private "TEKNOTRADE LTD." deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
Shoqëria fiton zotësinë e saj për të vepruar në regjistrin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj ekonomike me regjistrimin në organin përkatës tatimor.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj e cila është drejtkëndëshe me përmasa 35x10 mm, ku është i vendosur emri i firmës me kapitale.

Neni 10

Presidenti i firmës dhe Administratori i autorizuar prej tij janë të veshur me të gjithëfuqinë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë brenda rasteve të përcaktuara në këtë Statut dhe në legjislacionin përkatës.

Neni 11

Presidenti i shoqërisë cakton dhe shkarkon Administratorët, të cilëve me aktin e emërimit i cakton detyrat dhe pagën. Po kështu vepron edhe për punëtorët e punësuar.
Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe Sigurimet Shoqërore, ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë dhe të zbatojnë këtë Statut dhe aktet përkatëse ligjore të Shtetit.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 12

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk përfshihen në kontratën e punëszbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë kur nuk arrijnë të zgjidhen me marrëveshje do të zgjidhen nga gjykata shqiptare.
Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë ushtrimit të

veprimtarisë së saj, nëse në kontratën e punës nuk parashikohet ndryshe, gjithashtu nuk marrin pjesë në përballimin e humbjeve të saj.

Për punën e kryer punonjësit marrin pagën siç është parashikuar në kontratën e punës.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 13

Veprimet ekonomike dhe financjare të shoqërisë do të mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçanta të Asamblesë.

Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël i cili miratohet nga Presidenti dhe Asambleja. Në miratimin e bilancit Asambleja vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme, si fondi i akumulimit, fondi rezervë etj.

Neni 14

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendur më sipër dhe pagimit të detyrimit fiskal, i mbesin në përdorim ortakëve të shoqërisë.

Fitimi i realizuar nga shoqërija private do të ndahet në mes të ortakëve të saj në rraport me përqindjen e kapitalit të investuar.

Disponimi i fitimeve, transferimi, zmadhimi i kapitalit themeltar etj., do të bëhen sipas vendimit të themeluesve dhe legjislacionit në fuqi. Çdo transferim i pjesëve të kapitalit themeltar evidentohet me shkrim/

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 15

Shpërbërja e shoqërisë mund të bëhet në rast falimentimi, privimi të të drejtës për të ushtruar profesionin tregtar, në rast paaftësie që prek njërin prej ortakëve , vdekjeje të ortakut, kur ortakët vendosin me unanimitet për mosvazhdueshmërinë e saj si edhe në të gjitha rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Shoqëria "TEKNOTRADE LTD." për ushtrimin e aktivitetit të saj ka numrin e saj të llogarisë likujduese pranë bankës shqiptare, llogari kjo në valutë të huaj me nr. 1419/207 (Banka Kombëtare Tregtare) 774/3720 (Banka e Kursimeve) dhe lekë shqiptare me nr.1405/119 (Banka Kombëtare Tregtare), 774/3620 (Banka e Kursimeve).

Neni 17

Të drejtën e nënshkrimit në emër të shoqërisë "TEKNOTRADE LTD." e ka vetëm Presidenti i saj dhe të gjithë personat e autorizuar prej tij me autorizim të posaçëm.

Neni 18

Secili nga ortakët ka të drejtë dhe detyrë të kërkojë dhe të informojë reciprokisht ortakun tjetër për veprimtarinë e tij në kuadrin e firmës në çdo kohë.

Neni 19

Në rast falimentimi ortakët përgjigjen ndaj të tretëve tej fondit të themelimit dhe pasurisë së shoqërisë edhe me pasurinë vetjake në raportin 60 % Gianfranco LIUZZI dhe 40 % Angela CAMPANELLA.

Neni 20

Për dëmtimet e shkaktuara për faj individual, personi fajtor përgjigjet me të ardhurat e veta për çdëmtimin e interesave të shoqërisë.

Neni 21

Ndryshime në këtë statut mund të bëhen me miratim të themeluesve.

Neni 22

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k) e nënshkruar në të gjitha fletët e saj nga të dy ortakët.

ORTAK

Angela CAMPANELLA

Angela Campanella

Tiranë, me 19.10.1993

PRESIDENTI

Gianfranco LIUZZI

Gianfranco Liuzzi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A

Nr. 33672 Rep.
Nr. 10256 Kol.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me dt 28 .10.1993,para meje Mimoza Sadushi notere ne kete rreth,u paraqiten personalisht:GIANFRANCO LIUZZI dhe ANGELA CAMPANELLA,madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te panjohur prej meje,per indentitetin e te cileve u sigurova nga leternj oftimet e tyre personale me numer 804081 dhe 804082te cilet kane bere nje statut te nje shoqerie te perbashket tregetare,te hartuar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote,te cilen e kane nenshkruar rregullisht,si dhe une noteria e vertetoj konform dispozitave ligjore ne fuqi.

N o t e r e
Mimoza Sadushi

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E DREJTESISE NOTERIA

KONTRATE DHURIMI TE KUOTAVE TE KAPITALIT

Sot, me Tirane, me daten 21.10.2003 (njezet e nje tetor te vitit dymije e tre), bazuar ne nenin 761 e vijues te Kodit Civi si dhe ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 „Per Shoqerite Tregtare“, lidhet kjo kontrate per dhurimin e kuotave ne zoterim te kapitalit ne shoqerine “ Teknotrade” sh.p.k. mes paleve :

DHURUESI : Gianfranco Liuzzi, i biri i Oronzo, lindur me 6/04/1947 me Locorotondo, Bari, Itali, shtetas italian, mbajtes i pashaportes me numer 652377 N dhe banues ne Bari, Via „Conte Giusso“ 13/e, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut te Shoqerise „Teknotrade“sh.p.k qe zoteron 49 % (dyzet e nente perqind) te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, me seli ne Tirane Rruga „ Tefta Tashko“104/6, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 te Gjykates se Rrethit Tirane.

PRANUES I DHURIMIT : Geront Selenica, i biri i Mustafait, i datelindjes 20.05.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne RR „Myslym Shyri”, p.7, shk.5, Ap.50, per identitetin e te cilit u sigurova nga paspaporta me nr. Z.0184918, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut te Shoqerise „Teknotrade“sh.p.k qe zoteron 40 % (dyzet perqind) te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, me seli ne Tirane Rruga „ Tefta Tashko“104/6, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me vendimin e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise „TEKNOTRADE“ sh.p.k eshte miratuar transferimi i kuotave te kapitalit themeltar me ane te dhurimit nga ortaku **Gianfranco Liuzzi ortakut tjeter Geront Selenica.** **Dhuruesi, Gianfranco Liuzzi,** ortaku i shoqerise „Teknotrade“ sh.p.k,qe zoteron 49% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, e cila ka fituar personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Gjykaten e Rethit Tirane me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 , **I dhuron dhe Perfituesi i dhurimit, Z. Geront Selenica** edhe ky ortak i shoqerise „Teknotrade“ sh.p.k,qe zoteron aktualisht 40% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, **i pranon dhurimin e te gjitha kuotave te kapitalit qe dhuruesi zoteron ne shoqerine “ Teknotrade”sh.p.k**

Dhuruesi, dhe **Perfituesi i dhurimit** me vullnetin e tyre te lire kane rene dakort si me poshte :

NENI 1

Objekti i Dhurimit

Dhuruesi i dhuron **Perfituesi i dhurimit** te gjitha kuotat e kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine „ Teknotrade “ sh.p.k, qe aktualisht jane 49 % (dyzet e nente perqind) te

kuotave te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Teknotrade" sh.p.k, e shprehur ne vlere monetare keto kuota jane te barazvlereshme me 12 895 000(dymbedhjetemilioneteteqindenentedhjetepese) leke.

Dhuruesi Gianfranco Liuzzi, pas nenshkrimit te kesaj kontrate largohet nga shoqeria „ Teknotrade " sh.p.k duke hequr dore dhe nga funksioni si administrator i shoqerise.

NENI 2

Formimi i Kapitalit te Shoqerise

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, kapitali I shoqerise " Teknotrade" sh.p.k formohet si me poshte :

1. Z. Geront Selenica zoteron 89 kuota qe perbejne 89% (tetedhjete e nente perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise „ Teknotrade " sh.p.k. dhe ne vlere monetare 23 585 000(njezetetremilionepeseqindetetedhjetepesemije) leke.
2. Shoqeria " The Point" sh.p.k zoteron 11 kuota qe perbejne 11 % (njembedhjete perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise „ Teknotrade " sh.p.k.dhe ne vlere monetare 2 915 000(dymilionenenteqindepesembedhjetemije)leke.

NENI 3

Garancia e Dhurimit

Dhuruesi garanton **Pranuesin e Dhurimit** se objekti i dhurimit (49% e kuotave te kapitalit te shoqerise " Teknotrade" sh.p.k) eshte ne pronesi te tij ne momentin e dhurimit.

Dhuruesi garanton **Pranuesin e Dhurimit** se objekti i dhurimit (49% e kuotave te kapitalit te shoqerise " Teknotrade" sh.p.k) eshte i plote dhe nuk mund te pesoje zvogelim nga te tretet per shkak te detyrimeve te krijuara ndaj tyre para dates se nenshkrimit te kesaj kontrate .

NENI 4

Ligji i aplikueshem dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve

Kontrata eshte e bazuar ne legjislacionin shqiptar.

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne interpretimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate si dhe ne pergjithesi te gjitha mosmarreveshjet midis Dhuruesit dhe Perfituesit te Dhurimit, ne qoftese nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve do te zgjidhen ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 5

Gjuha e kontrates

Kjo Kontrate eshte hartuar ne kater kopje origjinale.

Kontrata pasi u lexua u firmos rregullisht nga palet.

DHURUESI

Gianfranco LIUZZI

PRANUESI I DHURIMIT

Geront SELENICA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.2548REP NR.535KOL
NOTERE DHIMITRA QARRI

VERTETIM

Ne Tirane sot me daten 21.10.2003 para meje noteres Dhimitra Qarri,anetare e Dhomes se Noterise Tirane,u paraqiten personalisht :

1. **Gianfranco Liuzzi** i biri i Oronzo, datlindjes 06.04.1947, shtetas italian i lindur ne Bari , Itali banues ne RR Conte Giusso 13/E, per identitetin e te cilit u sigurova nga paspaporta personale me nr 652377N, madhor me zotesi te plote per te vepruar,i cili komunikon shume mire ne gjuhen shqipe.
2. **Geront Selenica,** i biri i Mustafait, i datelindjes 20.05.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne RR „Myslym Shyri", p.7, shk.5, Ap.50, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta personale me nr. Z.0184918, me cilesine e ortakut te shoqerise " Teknotrade" sh.p.k, madhore me zotesi te plote per te vepruar, te cilet me vullnet te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte kontrate dhurimi kuotash ndermjet Ortakeve te Shoqerise " TEKNOTRADE" sh.p.k.e perpiluar jashte kesaj zyre noteriale, e nenshkruajne ne pranine time dhe une noteri e vertetoj ate pasi e gjej permbajtjen ne perputhje me ligjin 7638 „Per shoqerite Tregetare „.

REPUBLIKA E SHQIPERISE DHIMITRA QARRI NOTER TIRANE PULE TAKSE 100 LEKE

NOTERE
Dhimitra QARRI

7662/8

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA"TEKNOTRADE"SH.P.K

REPUBLIKA E SHQIPERISE OHMITRA XH. QARRI NOTER TIRANE

3 B Mucaj 22 10 2003

22 TETOR 2003

Tirane me 21.10.2003

K E R K E S E

